




Pranuar / Dorezuar Përmirësi/Prodato Received/Delivery	07-02-2023	3	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	1532/2023		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.93/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, dhe Malsore Gashi-anëtare Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.113/2023 të datës 23.01.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. ' ', në Komunën e Gjakovës, në çështjen juridike "shkelje e së drejtës në pagë", në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 16 paragrafit 3 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.02.2023, mori këtë:

#### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.93/2023 të datës 18.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

#### A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjakovës, në pozitën e punës "Zyrtare për Çështje Civile 1", me datën 18.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 461/2023 të regjistruar nën shenjën A.nr.93/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 16.01.2023 të Menaxherit të Zyrës së Personelit në Komunën e Gjakovës lidhur me refuzimin e kërkesës së ankueses për harmonizim të koeficientit nga pesë (5) në gjashtë (6).

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh se pretendimet ankimore të ankueses kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datën 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datën 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hy në fuqi me datën 05.02.2023. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe



kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshirë edhe koeficientët dhe nivelet e koeficientëve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafin 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficientëve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marrë parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.93/2023, datë 03/02/2023.

**Ardita Perçuku-SHYTI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuseses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës
- Arkivit të KPMSHCK-së.

